



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKË SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 10/04/2019

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “SISI-AL” shpk me NUIS K72117030P, me adresë:
Autostrada Tirane-Durres, Km 4, Perballe BMV-se, Kashar, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-10210-02-22-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Materiale për sinjalistikë (Semaforë)” afati: 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 9, Date 04.03.2019.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Shoqëria “I T E. Grup” shpk me NUIS K11323001H dhe me vlerë 11.154.000 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH.
2. Shoqëria “SISI-AL” shpk me NUIS K72117030P dhe me vlerë 11.130.800 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë mijë e tetëqind) leke pa TVSH.
3. Shoqëria “TechDigi” shpk me NUIS L62120006L dhe me vlerë 10.898.000 (dhjetë milion e tetëqindë e nëntëdhjetë e tetë mijë) leke pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “I T E. Grup” shpk me NUIS K11323001H
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - a) Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku thuhet se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi...." pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi/distributori për asnjë nga mallrat, objekt prokurimi.
 - b) Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku thuhet se "Operatori ekonomik

duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi **skeda teknike / katalogë** ku të pasqyrohen karakteristikat teknike të këtyre mallrave, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike." pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur skeda teknike/katalogë për zërin 1" Shtylla alumini me kokë horizontale me shirit LED".

- c) Nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik ku thuhet se "Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e mallrave të mëposhtëm, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s'kualifikim..."pasi Operatori Ekonomik nuk është paraqitur në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit për të dorëzuar mostrat e kërkuara.

2. "TechDigi" shpk me NUIS L62120006L

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Nuk përmbush pikën 1/a të Kriterëve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit ku thuhet se "Ofertuesi duhet të deklarojë se: a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse" pasi nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar në faqen zyrtare të QKB-së rezultoi se nuk e ka në fushën e veprimtarisë së tij, objektin e prokurimit. Operatori Ekonomik aktivitetin e tij e zhvillon në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
- b) Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku thuhet se "**Furnizime të ngjashme** të realizuara gjatë tre viteve të fundit **nga data e zhvillimit të tenderit, të aktivitetit të operatorit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 4.594.000 (katër milion e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH...**"pasi Operatori Ekonomik ka kryer furnizime me mallra jo të ngjashme me objektin e prokurimit, siç janë pajisje kompjuterike (PC, UPS, RACK, Laptop etj), shërbime instalimi të sistemeve të sigurisë (instalim kamerash etj) si dhe shërbime programimi të ndryshme.
- c) Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku thuhet se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi"pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi/distributori për zërin 1" Shtylla alumini me kokë horizontale me shirit LED".
- d) Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku thuhet se "Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi **skeda teknike / katalogë** ku të pasqyrohen karakteristikat teknike të këtyre mallrave, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike."pasi Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur skeda teknike/katalogë për zërin 1" Shtylla alumini me kokë horizontale me shirit LED".

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "**SI.SI-AL**" shpk me NUIS **K72117030P** dhe me adresë: Autostrada Tirane-Durres, Km 4, Perballe BMV-se, Kashar, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **11.130.800** (njëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 02.04.2019.

Ankesa: Nuk ka.

